



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË MALISHEVËS PËR VITIN 2024

Prishtinë, qershor 2025

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Malishevës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2024, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Malishevës (KMAL), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Malishevës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- B1 Keq klasifikimi i shpenzimeve në kategori ekonomike në vlerë 188,861€, si rezultat i pagesave sipas vendimeve gjyqësore përmbartimore;
- A1 Pasuritë e shpalosura në raportin vjetor financiar ishin nënvlerësuar për 43,119€, si rezultat i diferencës ndërmjet regjistrimit detaj të pasurisë jo kapitale nën 1,000€ me aneksin përkatës të prezantuar në PVF;
- B2 Në një rast, llogaritë e arkëtueshme të prezantuara në PVF ishin nënvlerësuar për 1,000€ dhe në nëntë raste në vlerë 35,438€, mungonin dokumentet burimore të llogarive të arkëtueshme;
- A2 Detyrimet kontigjente të shpalosura në raportin vjetor financiar ishin mbivlerësuar për 13,234€.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, për shkak të rëndësisë së çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të Komunës së Malishevës nuk kanë qenë në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- B3 Në 19 raste të obligimeve në vlerë 1,387,907€, kishte vonesa në pagesë nga 5 deri 120 ditë pas afatit të lejuar për pagesë;
- B4 Në katër raste në vlerë prej 1,202,644€, Komuna kishte hyrë në obligime kontraktuale pa fonde të mjaftueshme financiare;
- B5 Në 11 pagesa në vlerë 466,767€, ishin bërë ndryshime në shumat e ndara buxhetore të projekteve kapitale pa aprovim të Kuvendit Komunal;
- A3 Në një rast të procedurës së prokurimit në vlerë 59,975€, Komuna kishte shpërblyer me kontratë operatorin ekonomik (OE), i cili nuk i kishte plotësuar të gjitha kriteret e përcaktuara në dosjen e tenderit;
- A4 Në një rast me vlerë prej 52,360€, Komuna kishte lidhur Marrëveshje bashkëpunimi për realizimin e aktiviteteve në fushën e zhvillimit ekonomik, duke iu shmangur procedurave të prokurimit;
- B6 Në nëntë raste në vlerë 11,268€, kishte vonesa në mbylljen e avanceve/paradhënies për udhëtime zyrtare;
- A5 Në një rast në vlerë 7,675€ nuk ishin respektuar limitet e Rregullores së brendshme, me rastin e subvencionimit;
- A6 Në tetë raste në vlerë 2,400€, zyrtarët e komunës ishin paguar në kundërshtim me Rregulloren për kompensim për funksion shtesë;
- A7 Në një rast, ishte dhënë në shfrytëzim prona komunale jo në pajtim me tarifat e Rregullores komunale;
- A8 Tejkalimi i vlerës së kontratës kornizë me çmim për njësi dhe realizimi i kontratave kornizë për njësi jo në përputhje me peshën e kontraktuar;
- B7 Në dy raste, Komuna kishte iniciuar procedurat e prokurimit pa një projekt detal (ekzekutiv) të ndërtimit;
- A9 Komuna nuk kishte arritur që të bëjë verifikimin e 20% të pronave të tatueshme;
- A10 Angazhimi i katër konsulentëve për shërbime të veçanta, jo në pajtim me Rregulloren e Prokurimit Publik;
- A11 Në pesë raste, shqyrtimi i raportit për leje mjedisore komunale nuk ishte bërë nga një komision prej 3 anëtarëve siç kërkohet me Udhëzimi Administrativ Nr.01/2017.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Malishevës.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Malishevës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Malishevës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Malishevës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunes së Malishevës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Fushat në të cilat janë vërejtur mangësi sa i përket raportimit financiar janë: prezantimi jo i drejtë i shpenzimeve, nënvlerësimi i pasurive dhe llogarive të arkëtueshme, si dhe mbivlerësimi i detyrimeve kotigjente. Sa i përket mos pajtueshmërisë me ligje, kishte dobësi tek procesi i subvencionimit, procesi i kontraktimit, ridestinimi i projekteve kapitale, hyrje në obligime kontraktuale pa mbulesë, vonesa në pagesën e faturave, anashkalim i procedurave të prokurimit, tejkalim i vlerës së kontratave, dhënia në shfrytëzim e pronës komunale, vonesa në mbylljen e avanseve, si dhe inicimin i procedurave të prokurimit pa projekte ekzekutive.

Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me 24 rekomandime, prej tyre 14 janë rekomandime të reja dhe 10 të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja B1 - Keqklasifikim i shpenzimeve në kategorinë ekonomike

Gjetja

Rregulla Financiare Nr. 01/2013/MF "Shpenzimi i parasë publike" neni 18, përcakton që, shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me planin kontabël. Po ashtu, me planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB duhet të aplikojnë.

Në nëntë (9)⁵ pagesa në vlerë prej 188,861€ kemi identifikuar se komuna përmes vendimeve gjyqësore/përmbarimore kishte ekzekutuar pagesa në kategori jo adekuate si në vijim:

- Përmes vendimeve gjyqësore përmbarimore ishin ekzekutuar shpenzime në vlerë 41,465€ për mbulimin e obligimeve që rrjedhin nga kontrata kolektive për paga jubilarë dhe shujta. Nga kjo vlerë, 37,651€ ishin ekzekutuar nga kategoria e investimeve kapitale si dhe 3,814€ nga mallrat dhe shërbimet.
- Sipas vendimeve përmbarimore thesari kishte ekzekutuar pagesa nga investimet kapitale në vlerë prej 41,548€, shpenzime që për nga natyra i takojnë mallrave dhe shërbimeve.
- Po ashtu, përmes vendimeve gjyqësore, nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve ishin paguar 52,000€ shpenzime që për nga natyra i takojnë investimeve kapitale, si dhe nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve ishin paguar 53,848€, shpenzime që për nga natyra i takojnë po ashtu investimeve kapitale.

Klasifikimi joadekuat i shpenzimeve ishte rezultat i mosfunksionimit të mirë të kontrolleve të brendshme në planifikimin e buxhetit dhe vonesave në

pagesën me kohë të obligimeve.

Ndikimi Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve nga kategoritë ekonomike jo adekuate, ndikon në mbivlerësimin/nënvlerësimin e kategorive përkatëse të shpenzimeve duke shkaktuar prezantim jo të drejtë të shpenzimeve në raportin vjetor financiar.

Rekomandimi B1 Kryetari duhet të forcojë kontrollet e brendshme në mënyrë që të sigurojë planifikimin dhe realizimin e shpenzimeve në ndarjet adekuate të buxhetit në përputhje me planin kontabël, për të mundësuar raportim të drejtë të tyre në raportin vjetor financiar.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A1 - Mospërputhje mes regjistrit detal të pasurisë jo kapitale nën 1,000€ me aneksin përkatës të prezantuar në PVF

Gjetja Rregullorja 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar Organizatat Buxhetore, neni 6 përcakton që: “Organizatat Buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare”.

Bazuar në rishikimin analitik të pasqyrave vjetore financiare të komunës, kemi vërejtur një nënvlerësim prej 43,119€ të regjistrit të pasurive të prezantuar në PVF. Kjo për shkak se, tek neni 19.3.2 i PFV-ve Pasuritë jo kapitale me vlerë nën 1,000€ i, ishin shpalosur në vlerë 279,500€, ndërsa vlera e pasurive sipas regjistrit detal analitik të pasurive nën 1,000€ të cilin komuna e mban në formë të excelit kishte vlerën 322,619€.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mungesës së kontrolleve të brendshme me rastin e raportimit të pasurisë në PVF.

Ndikimi Prezantimi i pasurive në vlera jo të sakta ndikon që vlera e pasurive të paraqitura në raportin vjetor financiar të jetë e nënvlerësuar.

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të forcojë kontrollet e brendshme në raportimin e drejtë të pasurive në mënyrë që të mundësohet prezantimi i saktë dhe i plotë i tyre në PVF.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Mungesë e dëshmive dhe nënvlerësim i llogarive të arkëtueshme të prezantuara në raportin vjetor financiar

Gjetja Rregullorja MF-Nr.01/2017 për Raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore, neni 6 përcakton që, organizatat buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare”.

Në tetë (8)⁶ raste tek llogaritë e arkëtueshme të taksës për ushtrimin e veprimtarisë në vlerë 34,238€ dhe në një rast tek qiratë nga shfrytëzimi i pronës komunale në vlerë 1,200€, Komuna nuk disponon dokumentet burimore për të mbështetur vlerat e prezantuara dhe të drejtën e komunës sa i përket këtyre llogarive të arkëtueshme.

Më tutje, në një rast të llogarive të arkëtueshme të taksës për ushtrimin e veprimtarisë, kishte diferencë ndërmjet vlerës së prezantuar në regjistër, me vlerën bazuar në dokumentet burimore, ku si rezultat, vlera e llogarive të arkëtueshme të prezantuara në PVF ishte nënvlerësuar për 1,000€.

Kjo ka ndodhur si pasojë e mos funksionimit të duhur të kontrolleve të brendshme në regjistrimin dhe ruajtjen e dokumentacionit për llogaritë e arkëtueshme nga ana e zyrtarëve përgjegjës.

Ndikimi	Nënvlerësimi i regjistrit dhe mungesa e dëshmive për llogaritë e arkëtueshme, përveç që ndikon në mos raportim të saktë dhe të drejtë të tyre në PVF, pamundëson edhe marrjen e veprimeve ligjore për inkasimin e tyre.
Rekomandimi B2	Kryetari duhet të sigurojë se zyrtarët përgjegjës mbajnë regjistra të saktë, si dhe ruajnë dhe mirëmbajnë dokumentacionin burimor në përputhje me kërkesat ligjore për llogaritë e arkëtueshme të prezantuara në PVF.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Prezantim jo i saktë i detyrimeve kontigjente

Gjetja	Rregullorja e MF Nr.01/20217, për raportim vjetor financiar, Neni 6, parasheh se: “Organizatat buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare”, ndërsa neni 18 përcakton që organizatat buxhetore në harmoni me LMFPP-në raportojnë të gjitha detyrimet kontigjente.
---------------	---

Detyrimet Kontigjente në PVF ishin mbivlerësuar për 13,234€, si rezultat i gabimeve në vijim:

- Në pesë (5) raste detyrimet kontigjente janë mbivlerësuar për 19,777€, për shkak se me rastin e vendosjes së vlerave në regjistër nuk ishin marrë për bazë vlerat bazuar në Aktgjykimet e fundit; dhe
- Në dy (2) raste, detyrimet kontigjente ishin nënvlerësuar për 6,543€, si shkak i mos përfshirjes së të gjitha shpenzimeve që i takojnë lëndëve përkatëse.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mos komunikimit të mirëfilltë ndërmjet zyrës ligjore dhe asaj të financave si dhe funksionimi jo efikas i kontrolleve të brendshme në përditësimin e regjistrave kontabël.

Ndikimi	Prezantimi i detyrimeve kontingjente në vlera jo të sakta ndikon në mbivlerësimin/nënvlerësimin e tyre, si dhe palët e interesit apo shfrytëzuesit e raportin vjetor financiar të mos informohen drejtë dhe saktë lidhur me vlerën e detyrimeve kontingjente.
Rekomandimi A2	Kryetari duhet të sigurojë përforcimin e komunikimit në mes sektorit të financave dhe përfaqësuesit ligjor të komunës, me qëllim që informacioni financiar në regjistrin e detyrimeve kontigjente dhe raportimi i tyre të jetë i saktë në PVF.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja B3 - Vonesë në pagesën e obligimeve ndaj furnitorëve

Gjetja Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP), neni 39.1 parasheh që: “ZKF i organizatës buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhet brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore”.

Në 19⁷ raste, në vlerë prej 1,387,907€, faturat nuk ishin paguar brenda afatit ligjor. Vonesat ishin nga 5 ditë deri në 120 ditë pas afatit të lejuar për pagesë prej 30 ditësh.

Kjo kishte ndodhur kryesisht si rezultat i mungesës së mjeteve financiare për shkak të pagesave të pa planifikuara përmes vendimeve gjyqësore.

Ndikimi Tejkalmi i afatit ligjor për pagesën e faturave mund ta bëjë komunën subjekt të padive nga operatorët ekonomik, duke shkaktuar shpenzime shtesë gjyqësore/përmbarimore apo obligime për vitin vijues.

Rekomandimi B3 Kryetari duhet të sigurojë fonde të mjaftueshme të mjeteve në mënyrë që të gjitha faturat e pranuar paguhet brenda 30 ditëve pas pranimit të tyre.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B4 - Hyrja në obligime kontraktuale pa fonde të mjaftueshme

Gjetja Ligji nr 03/L-221 për ndryshim dhe plotësim të ligjit Nr.0/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi, neni 37.1 përcakton se: “Organizata buxhetore nuk ndërmerr asnjë obligim gjatë vitit aktual fiskal në një shumë që i tejkalon fondet e ndara”. Ligji për prokurimin publik, neni 9.2, përcakton që: “ZKF siguron se ka mjete financiare në dispozicion për prokurimin përkatës. Nëse autoriteti kontraktues është autoritet publik ose organizatë buxhetore, ZKF në pajtim me dispozitat e aplikueshme të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publik dhe Përgjegjësitë dhe Rregullat Financiare do të sigurojë nëse janë ndarë mjete të mjaftueshme financiare për prokurimin përkatës në shumë të mjaftueshme për përmbushjen e detyrimeve që mund të dalin si rezultat i prokurimit në fjalë gjatë vitit aktual fiskal”. Më tutje, neni 9.3 i ligjit të njejtë, specifikon që: “Nëse autoriteti kontraktues organizatë buxhetore dhe prokurimi përkatës do të shkaktojë ngritjen e obligimeve financiare të cilat do të përmbushen nga ndarjet buxhetore që pritet të bëhen në vitet e ardhshme fiskale, ZKF do të (i) sigurojë që tabelat e bashkëngjitura Ligjit për Ndarjet Buxhetore ofrojnë bazë të arsyeshme për të pritur se në vitet e ardhshme fiskale do t’i ofrohen fonde të mjaftueshme për përmbushjen e obligimeve të tilla”.

Komuna kishte hyrë në obligime kontraktuale pa fonde të mjaftueshme financiare në kundërshtim me ligjin për ndarjet buxhetore si në vijim:

- Për kontratën dy (2) vjeçare “Rregullimi dhe ndërtimi i kanalizimeve të ujërave të zeza në fshatrat Banjë, Mirushë, Kërvasari, Temeqinë, Ngucat, Senik, Pagarushë, Kijevë, Gurbardhë, Shkarashnik, Drenoc, Vermicë, Bellanicë, Gurishtë, Burim, Malishevë, Bubavecë, Panorc, Astrazup, Dragobil, Plloqic, Balincë, Berishë, Jançishtë, Carrallukë dhe Lladroc” në vlerë 408,920€, me ligjin e buxhetit ishin paraparë vetëm 200,000€, për dy vite buxhetore sa ishte plani dinamik i kontratës, me ç ‘rast vlera e obligimeve kontraktuale pa mbulesë ishte 208,920€;
- Kontrata dy (2) vjeçare “Punimi i lapidarit të dëshmorit Ilay Javori në fshatin Llozicë, Komuna e Malishevës” në vlerë 10,710€, ishte nënshkruar duke mos pasur fare mjete të buxhetuara me ligjin e buxhetit për vitin 2024 për këtë projekt, duke rezultuar me obligime kontraktuale pa mbulesë në vlerë, 10,710€;
- Për kontratën “Punimi i murit mbrojtës dhe rregullimi i rreth rrotullimi në fshatin Pagarush Komuna e Malishevës” në vlerë 74,106€, e cila ishte projekt i përbashkët me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, ku komunës i takonte financimi prej 24,106€. Me ligjin e buxhetit për vitin 2024, komuna nuk kishte mjete të ndara për këtë projekt, me ç ‘rast vlera e obligimeve kontraktuale pa mbulesë ishte 24,106€;
- Për kontratën “Ndërtimi, trajtimi dhe pastrimi i shtratit të lumit me strukturën përcjellëse nga ura në qendër deri tek tranziti” në vlerë 1,487,459€, e cila ishte projekt i përbashkët me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe DEMOS, ku komunës i takonte financimi prej 858,908€. Me ligjin e buxhetit për vitin 2024, komuna nuk kishte mjete të ndara për këtë projekt, me ç ‘rast vlera e obligimeve kontraktuale pa mbulesë ishte 858,908€.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mos përgjegjësisë së mbajtësve të buxhetit për respektimin e limiteve të ndarjeve buxhetore të projekteve të caktuara me rastin e nënshkrimit të kontratave.

Ndikimi

Hyrja në obligime financiare pa siguruar fondet e nevojshme ndikon në rritjen e obligimeve apo mundësinë e e shpenzimeve të përmbarimit duke dëmtuar kështu buxhetin e vitit aktual dhe viteve vijuese.

Rekomandimi B4

Kryetari duhet të sigurohet që para inicimit të procedurave të prokurimit për projektet kapitale, për të njëjtat ka fonde të mjaftueshme buxhetore të parapara në ligjin e buxhetit dhe kornizën afatmesme të shpenzimeve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B5 - Ndryshimet në shumat e ndara buxhetore të projekteve kapitale pa aprovim të Kuvendit Komunal

Gjetja

Ligji Nr. 08-L-260 për ndarjet buxhetore për vitin 2024, neni 16, pika 11, përcakton që: "Ndryshimet në shumat e ndara buxhetore për projektet ekzistuese si rezultat i transfereve dhe/ose rialokimeve, të prezantuara në tabelën 4.2, duke përfshirë edhe të hyrat vetanake të bartura, si dhe të regjistruara në SIMFK, duhet të aprovohen paraprakisht nga Kuvendi Komunal"

Në 11^s pagesa të projekteve kapitale në vlerë prej 466,767€, ishin marrëfondet nga projekte tjera të aprovuara në ligjin e buxhetit. Këto ndryshime në shumat e ndara buxhetore ishin bërë pa marrë aprovimet e

Kuvendit Komunal për ridestitim të fondeve.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mos përgjegjësisë së menaxhmentit të komunës për të zbatuar kërkesat e ligjit të buxhetit lidhur me ndryshimet buxhetore.

Ndikimi

Ndryshimet në shumat buxhetore pa aprovim të Kuvendit Komunal mund të reduktojnë transparencën dhe llogaridhënien në vendimet e marra rreth shfrytëzimit të fondeve publike. Po ashtu, mund të kenë ndikim negativ në implementimin e projekteve ekzistuese duke pamundësuar financimin e mjaftueshëm të tyre.

Rekomandimi B5

Kryetari duhet të sigurojë se për çdo ndryshim në shumat buxhetore të projekteve të aprovuara në ligjin e buxhetit, të marrë paraprakisht aprovimin e Kuvendit Komunal.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A3 - Përzgjedhja e operatorit ekonomik të papërgjegjshëm gjatë procesit të vlerësimit të ofertave në procedurat e prokurimit

Gjetja

Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, neni 59, paragrafi 4, përcakton se, autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Më tutje, Dosja e Tenderit e datës 15.04.2024, për kontraktimin e shërbimeve për “Spërkatje nga toka e zonave endemike nga ethet hemorragjike”, në kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, pika 2, parasheh që OE duhet të ketë leje për importim dhe përdorim të produkteve biocide.

Në procedurën e prokurimit për kontratën “Spërkatje nga toka e zonave endemike nga ethet hemorragjike”, në vlerë 59,975€, grupi i operatorëve ekonomik fitues, nuk kishte bashkangjitur në dosjen e ofertës, lejen valide për importimin dhe përdorimin e produkteve biocide. OE kishte ofruar lejen e njëjtë të lëshuar nga MMPHI më 07.06.2022, me vlefshmëri një vjeçare, por që e njëjta nuk ishte valide për këtë proces.

Kjo kishte ndodhur për shkak të pakujdesisë dhe kontrolleve të pamjaftueshme gjatë vlerësimit të tenderëve nga komisioni i vlerësimit.

Ndikimi

Përzgjedhja e operatorëve ekonomik fitues të cilët nuk i plotësojnë në tërësi kërkesat e dosjes së tenderit rrezikon cilësinë e realizimit të kontratës, si dhe besueshmërinë në procesin e prokurimit.

Rekomandimi A3

Kryetari duhet të ndërmarrë masa për forcimin e mekanizmave të kontrollit në procesin e vlerësimit të tenderëve, me qëllim që vlerësimi i ofertave të realizohet në përputhje të plotë me kërkesat e përcaktuara në dosjen e tenderit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A4 - Shmangie e procedurave të prokurimit**Gjetja**

Ligji nr. 03/L-241 i prokurimit publik, neni 3.5, përcakton që ky ligj nuk zbatohet për aktivitetet e prokurimit që qojnë në dhënien e një kontrate publike, që bie në fushën e veprimit të një marrëveshje, që parashikon zbatimin e rregullave dhe/ose procedurave të tjera të prokurimit, ku (i) kjo marrëveshje e kushtëzon disponueshmërinë e financimit të kontratës në fjalë me zbatimin e rregullave dhe/ose procedurave të tjera, dhe (ii) marrëveshja është lidhur ndërmjet Qeverisë dhe një institucioni financiar ndërqeveritar, dypalësh, shumëpalësh ose ndërkombëtar. Po ashtu, Rregulla financiare nr.01/2013/MF - Shpenzimi i parave publike, neni 21.2, përcakton që shpenzimet që nuk kërkojnë prokurim janë: Pagat, Shpenzimet e paguara me para e imët, Avancat për udhëtime, Komunalit, Subvencionet dhe Transferet, Transaksionet ndërdepartamentale.

Komuna kishte bërë pagesë prej 5,000€ bazuar në një marrëveshje bashkëpunimi të lidhur në vitin 2023 me Organizatën Jo Qeveritare "Agjencioni i Zhvillimit Rajonal - Jugor" ku si qëllim i kësaj marrëveshje thuhej se ishte zhvillimi socio-ekonomik dhe ngritja e kapaciteteve njerëzore të komunës. Në marrëveshje nuk specifikoheshin qartë obligimet e komunës në raport me këtë marrëveshje, mirëpo vetëm thuhej se komuna financon projektin dhe në bashkëpunim me AZhR e implementon të njëjtën. Përderisa, sa i përket obligimeve të AZhR-së, specifikohet se e njëjta do të zhvilloj të gjitha procedurat financiare dhe operacionale të këtij projekti. Më tutje, në emër të kësaj marrëveshje, AZhR kishte angazhuar gjashtë (6) punonjës në cilësinë e konsulentëve, respektivisht si pjesë e ekipit për projekte me interes për komunën dhe bazuar në këtë, komuna kishte pranuar kërkesën e AZhR për pagesën e obligimeve ndaj saj në vlerë 52,360€, që lidhen me pagesat për shërbimet e konsulentëve.

Marrëveshja përkatëse ishte bërë duke i shmangur procedurat e prokurimit që kërkojnë rastin e kontraktimit të shërbimeve dhe për më tepër nuk mund të matej dhe dokumentohej përfitimi i komunës nga kjo marrëveshje.

Kjo kishte ndodhur për shkak të pa përgjegjësisë së komunës për zbatim të rregullave përkatëse të prokurimit nga ana e personave përgjegjës.

Ndikimi

Lidhja e marrëveshjeve të bashkëpunimit për shërbime për të cilat nuk mund të matet përfitimi i komunës dhe duke shmangur procedurat e prokurimit, përveçse dëmton konkurrencën dhe transparencën e procesit, ndikon në pagesa të parregullta që dëmtojnë objektivat e komunës.

Rekomandimi A4

Kryetari duhet të sigurojë se marrëveshjet e bashkëpunimit të lidhen vetëm në rastet kur përfitimi i komunës është i qartë, derisa shërbimet të kontraktohen duke i zbatuar procedurat e prokurimit publik.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B6 - Vonesa në mbylljen e avanceve/paradhënieve për udhëtime zyrtare

Gjetja Rregullorja nr. 06/2023 për kompensimin e udhëtimeve zyrtare dhe shpenzimeve të përfaqësimit, neni 9, paragrafi 4, përcakton se: kërkesa për kompensim dhe shpenzime të vogla së bashku me të gjitha dëshmitë për shpenzimet financiare i dorëzohet njësisë përkatëse për buxhet dhe financa brenda pesëmbëdhjetë (15) ditë pune, nga dita e përfundimit të udhëtimit zyrtar. Poashtu, neni 10, paragrafi 4, parasheh se në rast kur zyrtari nuk kthen shumën, ajo do të ndalohet sipas sistemit të pagave.

Në nëntë (9) raste në vlerë 11,268€, kemi identifikuar që avancet e dhëna për udhëtime zyrtare nuk ishin mbyllur brenda afatit ligjor 15 ditësh pas kthimit nga udhëtimi zyrtar. Vonesat ishin nga 60 ditë deri në 211 ditë. Përkundër vonesave në mbyllje nga ana e zyrtarëve, komuna nuk kishte aplikuar ndalesën përmes sistemit të pagave, siç kërkohet me rregulloren përkatëse.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mos funksionimit të kontrolleve të brendshme në zyrën e financave dhe mungesës së veprimeve të nevojshme nga njësia e Burimeve Njerëzore për zbatimin e ndalesave sipas kërkesave ligjore.

Ndikimi Mos arsyetimi i shpenzimeve të udhëtimeve zyrtare brenda afatit ligjor dhe mos mbyllja e avanceve shton rrezikun e keqpërdorimit dhe mundësinë që fondet publike të përdoren në kundërshtim me qëllimet e synuara.

Rekomandimi B6 Kryetari duhet të sigurojë që të gjitha avancet për udhëtime zyrtare duhet të arsyetohen dhe shumat e pashpenzuara të kthehen në afat prej 15 ditësh pas kthimit nga udhëtimi. Për zyrtaret të cilët nuk i kanë arsyetuar ose kthyer mjetet e pranuar-avancet, duhet të sigurojë ndalesën përmes sistemit të pagave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja A5 - Tejkallim i limiteve të aprovimeve të lejuara me rregulloren e brendshme për subvencionim**

Gjetja Rregullorja Komunës nr. 02/236, për Subvencione dhe Transfere, Neni 8, paragrafi 9, përcakton që: Kryetari merr vendim për ndarjen e subvencioneve në shumën deri në 1,000€, ndërsa, për shumën mbi 1,000€, Kuvendi Komunal merr vendim për ndarjen e subvencioneve .

Në një rast të subvencionimit, Kryetari i Komunës kishte marrë vendim për përkrahje të një përfituesi individual për ndërtimin e shtëpisë së djegur nga zjarri në vlerë 7,675€, duke tejkalluar limitin prej 1,000€, të paraparë me rregulloren e brendshme.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mos zbatimit të procedurave dhe akteve rregullative përkatëse për subvencionim.

Ndikimi Dhënia e subvencioneve jo në pajtim me limitet e përcaktuara me

rregulloren përkatëse për subvencionim ndikon që fondet të mos shfrytëzohen në mënyrë efektive dhe qëllimi i subvencionimit mos të arrihet.

Rekomandimi A5 Kryetari duhet të sigurojë respektimin e limiteve me rastin e subvencionimit, derisa në rastet e përkrahjeve mbi 1,000€, të merret aprovimi dhe vendimi i Kuvendit Komunal, bazuar në kërkesat e rregullores së brendshme për subvencionim.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A6 - Kompensimet e zyrtarëve të komunës në kundërshtim me Rregulloren për kompensim për funksion shtesë

Gjetja Rregullore (QRK) nr.10/2023 për kompensimin për funksion shtesë, neni 4, përcakton që, Zyrtari publik i cili emërohet/caktohet që të shërbejnë në një bord, komision profesional apo organ tjetër publik që kërkon ekspertizë profesionale dhe përbën funksion shtesë për këtë funksion. Ky kompensim nuk nënkupton detyrat dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga pozita të cilën e mban zyrtari publik, përfshirë këtu edhe pjesëmarrjen në komisione dhe/apo organe të tjera të themeluara brenda institucionit. Më tutje, neni 5, i rregullores se njejte përcakton që, nëse një zyrtar publik i një autoriteti publik ose organizatë buxhetore, kërkohet që të shërbejë në ndonjë grup, ekip punues, autoritet apo organe të ngjashme ky zyrtar publik nuk ka të drejtë të pranojë, dhe nuk do të pranojë, kurrfarë kompensimi shtesë për këtë shërbim. Shërbimi konsiderohet pjesë e detyrave të obligueshme e zyrtarit të cilin e mban punonjësi, shërbyesi civil ose zyrtari i sipër cekur. Përgjigjet, kompensimi për funksionin shtesë mund të përfitohet kur plotësohen në mënyrë kumulative kriteret e mëposhtme: 2.1.themelimi i Komisionit/Bordit parashihet në ligj apo akt nënligjor; 2.2. përfshirja në komision përbën funksion shtesë për zyrtarin publik; 2.3. funksioni nuk bënë pjesë tek detyrat e obligueshme të pozitës të cilën zyrtari publik e mbanë; 2.4. përfshirja në Komision kërkon ekspertizë profesionale të cilën zyrtari e posedon; 2.5. komisionet/bordet të cilat kanë kompetenca Vendim-marrëse në procedurë administrative; 2.6. komisioni/bordi nuk themelohet nga institucioni ku zyrtari publik është i punësuar.

Me vendim të Kryetarit të Komunës ishte lejuar financimi i organizimit të Festivalit dy ditor “Oda e Llaushës”, bazuar në kërkesën e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit (DKRS). Ndër aktivitetet e financuara, ishte edhe pagesa e tetë anëtareve të Këshillit organizativ të këtij festivali, të cilët ishin edhe zyrtar publik të punësuar pranë komunës. Bazuar në specifikacionin e kësaj pagese, detyrat e anëtareve të këshillit ishin që të kryenin punët rreth organizimit dhe mbarëvajtjes së festivalit dhe për këto detyra secili anëtar do të paguhej 300€, në total 2,400€.

Bazuar në kriteret e përmendura në rregulloren përkatëse për funksion shtesë, detyrat e kryera nga këta zyrtarë, ishin përgjegjësi që rrjedhin nga pozita të cilën ata e mbanin dhe nuk përbënin funksion shtesë, andaj, si të tilla përbëjnë pagesa në kundërshtim me këtë rregullore.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mosfunksionimit të kontrolleve të brendshme me rastin e vendimit për lejim të këtyre pagesave.

Ndikimi Kompensimi i zyrtarëve të komunës në emër të funksioneve shtesë për punë që nuk plotësojnë kriteret e kualifikimit si të tilla, ndikon në

kompensime të parregullta dhe jo ligjore.

Rekomandimi A6 Kryetari duhet të sigurojë që kompensimet për funksione shtesë të zyrtarëve të komunës, bëhen vetëm në rastet kur të njëjtët kryejnë detyra të cilat i plotësojnë kriteret e rregullores përkatëse për funksione shtesë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A7 - Dhënia në shfrytëzim e pronës komunale jo në pajtim me tarifat e Rregullores komunale

Gjetja Rregullorja e komunës nr. 02/31 për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale për vitin 2024, neni 15 paragrafi 2, përcakton që, shfrytëzimi i përkohshëm i pronës komunale me ndërtime të forta për banim apo afarizëm, tarifa për m² është 4€.

Në një rast të dhënies në shfrytëzim të përkohshëm (afatshkurtër) të pronës komunale, Pishinë në Banjë të Malishevës në sipërfaqe prej 5147m², Komuna, kishte aplikuar tarifë vjetore prej 3€ për metër katror, jo përputhje me tarifën prej 4€, të përcaktuar me rregulloren e komunës për taksa, ngarkesa dhe gjoba, duke e dëmtuar buxhetin për shkak të inkasimit më të ulët të të hyrave për 5,147€. Kjo ishte bërë duke e aplikuar tarifën për shfrytëzimin e kiosqeve dhe objekteve montazhi dhe jo tarifën me ndërtime të forta për banim apo afarizëm, marrë parasysh faktin se pishinat dhe objekti janë ndërtim i fortë dhe jo objekte montazhi.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mos përgjegjësisë së personave përgjegjës për aplikim të drejtë të tarifave për shfrytëzimin e pronave komunale, në përputhje me normat e vendosura në rregulloren përkatëse.

Ndikimi Dhënia në shfrytëzim afatshkurtër e pronës komunale me tarifa më të ulta se sa ato të përcaktuara me rregulloren e komunës, ka dëmtuar buxhetin e komunës dhe rrjedhimisht edhe objektivat e saj.

Rekomandimi A7 Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve të brendshme në aplikimin e tarifave me rastin e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale, duke respektuar normat e përcaktuara me rregulloren komunale, në mënyrë që të mos dëmtohet buxheti dhe objektivat e komunës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A8 - Tejkalmi i vlerës së kontraktuar të kontratës kornizë dhe realizimi i saj jo në përputhje me peshën e përcaktuar në dosje të tenderit/kontratë**Gjetja**

Rregullorja nr.002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores nr.001/2022 për prokurimin publik, neni 54.15, specifikon se, kurdo që Autoriteti kontraktues nuk dinë sasi të indikative, kontratat me çmime për njësi, AK duhet të përcaktoj peshat në bazë të rëndësisë së secilës "kategori të shërbimeve/artikujve" në mënyrë që Autoriteti Kontraktues të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët. Në këto raste nuk vlen pragu apo tavani plus/minus tridhjetë për qind (30%), si p.sh. mirëmbajtje të veturave, mirëmbajtje të gjeneratorëve, pajisjeve të ndryshme etj. Në hapje publike të ofertave lexohet çmimi total i poentuar (peshuar) i cili shërben vetëm për qëllim të vlerësimit të ofertave ndërsa kontrata lidhet me çmime për njësi dhe mund të realizohet deri në vlerë të parashikuar. Shuma e sigurimit të ekzekutimit të kontratës në këto raste duhet të përcaktohet si shumë fikse. Kontratat me çmime për njësi mund të udhëhiqen për llojet e kontratave për furnizime dhe shërbime. Kërkesat nga ky paragraf duhet të vendosen në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë.

Gjatë realizimit të kontratave me peshim, kemi identifikuar mangësitë si në vijim:

- Në kontratën kornizë të peshuar për Mirëmbajtjen e kanalizimit fekal⁹ të nënshkruar më 29/07/2022 me vlerë 425,000€, Komuna gjatë realizimit të kësaj kontrate ka bërë tejkalimin e vlerës së kontraktuar për 127,466€, duke rezultuar me shpenzime totale prej 552,466€ sa i përket kësaj kontrate. Po ashtu, tek kontrata e njëjtë nuk ishte zbatuar raporti i peshimit të pozicioneve, siç ishte përcaktuar me kontratë dhe dosje të tenderit, Kjo pasi që, tek kategoria e parë ishte kontraktuar 5%, ndërsa shpenzimi për këtë pozicion ishte 6%, kategoria e dytë ishte kontraktuar 25%, ndërsa shpenzimi ishte 59%, kategoria e tretë ishte kontraktuar 20%, ndërsa shpenzimi ishte 2%, si dhe kategoria e katërt ishte kontraktuar 5%, ndërsa shpenzimi ishte 23%.
- Në kontratën kornizë të peshuar për trajtimin e deponive inerte të nënshkruar më 15/11/2022 me vlerë 147,000€, Komuna gjatë realizimit kishte bërë tejkalimin e vlerës kontraktuar për 12,100€, duke rezultuar me shpenzime totale prej 159,100€, sa i përket kësaj kontrate. Po ashtu, në kontratën e njëjtë në një pozicion, konkretisht, tek kategoria e tretë, nuk ishte zbatuar raporti i peshimit, siç ishte përcaktuar me kontratë, me ç'rast ishte kontraktuar 40% ndërsa, shpenzimi ishte 57.3%.
- Në kontratën kornizë të peshuar për furnizimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të ngrohjeve qendrore në Institucionet Arsimore të Komunës së Malishevës, të nënshkruar më 19/08/2022, me vlerë 200,000€, Komuna gjatë realizimit të kësaj kontrate kishte bërë tejkalimin e vlerës kontraktuar për 56,324€, duke rezultuar me shpenzime totale prej 256,324€, sa i përket kësaj kontrate. Po ashtu, nuk ishte zbatuar raportii i peshimit siç ishte përcaktuar me kontratë dhe dosje të tenderit, me ç'rast kategoria e tretë ishte kontraktuar 15%, ndërsa, shpenzimi ishte 26%, kategoria e katërt ishte kontraktuar 50% ndërsa shpenzimi ishte 57%.
- Në kontratën kornizë të peshuar për rrënimin e ndërtimeve pa leje ndërtimore në territorin e Komunës së Malishevës, në vlerë 180,000€, e nënshkruar më 16/11/2022, Komuna gjatë realizimit nuk

kishte zbatuar raportin e peshimit me shpenzim siç ishte përcaktuar me kontratë dhe dosje të tenderit, me ç'rast kategoria e parë ishte kontraktuar 5% ndërsa, shpenzimi ishte 24%, kategoria e katërt ishte kontraktuar 35% kurse, shpenzimi ishte 45%.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mangësive në planifikimin e saktë të nevojave dhe mbikëqyrjes së dobët nga ana menaxherëve të kontratave.

Ndikimi Tejkalmi i vlerës së kategorive sipas peshimit, ndikon në mungesë të transparencës për zgjedhjen e ofertës me çmimin më të ulët. Kjo po ashtu, mund të ndikojë në shpenzime të pa planifikuara buxhetore.

Rekomandimi A8 Kryetari duhet të siguroj përmes njësive kërkuese dhe departamentit të prokurimit, që gjatë përgatitjes së kërkesave dhe dosjeve të tenderit për kontratat publike kornizë sipas peshimit, të luajnë një rol aktiv në përcaktimin e nevojave reale. Po ashtu nevojitet mbikëqyrje më aktive gjatë realizimit të kontratave nga ana e menaxherëve të kontratave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B7 - Mungesa e projektit ekzekutues

Gjetja Rregullorja Nr.001/2022 për Prokurimin Publik, paragrafi 19.17 i ndër tjerash parasheh se Autoriteti Kontraktues është përgjegjës për hartimin e projektit ekzekutues dhe i cili në mënyrë mandatore duhet t'i bashkëngjitet (gjithashtu në pajisje elektronike) Specifikave Teknike, të cilat janë pjesë të dosjes së tenderit. Asnjë Autoriteti Kontraktues nuk i lejohet që të lëshojë dokumentacionin e tenderit pa bashkëngjitur përshkrimin e hollësishëm të projektit.

Në dy¹⁰ projekte kapitale në vlerë 419,630€, Komuna kishte zhvilluar procedurat e prokurimit dhe kishte lidhur kontrata për projektet përkatëse, pa u hartuar paraprakisht projektet ekzekutive, por vetëm bazuar në specifikacionet teknike.

Kjo kishte ndodhur për shkak të kontrolleve të mangëta tek njësitë kërkuese dhe zyra e prokurimit për përgatitjen e projektit detal sipas kërkesave ligjore.

Ndikimi Inicimi i procedurës së prokurimit në mungesë të projektit ekzekutiv, mund të ndikoj në realizim të dobët të kontratave për punë si dhe mund të shkaktojë shpenzim të paparashikuar apo vlerë të dobët për paranë e shpenzuar.

Rekomandimi B7 Kryetari duhet të sigurojë kontrolle efektive tek njësit kërkuese dhe zyrën e prokurimit, ashtu që me rastin e inicimit të procedurave të prokurimit për kontraktimin e punëve/ndërtimit, paraprakisht të bëhet hartimi i projekteve në përputhje me nevojat dhe kërkesat e parashikuara.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A9 - Mos inspektimi i 20% të pronave të tatueshme për tatimin në pronë

Gjetja Ligji nr. 06/L-005 për Tatimin në pronën e paluajtshme, nenit 15, parasheh se: "Komuna çdo vit duhet të kryejë veprime të inspektimit (verifikimit) për të paktën 20% e të gjitha pronave brenda territorit të Komunës".

Komuna gjatë vitit 2024 nuk kishte arritur të bëjë inspektimin (verifikim) e 20% të pronave brenda territorit të Komunës, mirëpo brenda vitit kishte arritur të realizonte verifikimin e vetëm 11% të pronave.

Kjo kishte ndodhur për shkak të kontrolleve të mangëta dhe angazhimeve të pamjaftueshme për verifikimin e pronave sipas kërkesave ligjore.

Ndikimi Mos inspektimi i pronave rezulton me informata jo të plota të pronave aktuale dhe me ndikim në vlerësim jo të drejtë dhe të saktë të ngarkesave për tatimin në pronë, respektivisht pranime më të ulëta të të hyrave vetanake nga tatimi në pronë.

Rekomandimi A9 Kryetari duhet të sigurojë rritjen e aktiviteteve për verifikim të pronave të paluajtshme, sipas kërkesave ligjore, në mënyrë që ndryshimet eventuale të pronave të integrohen në bazën e të dhënave për të reflektuar detyrimin e saktë tatimor.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja A10 - Zhvillimi i procedurave të prokurimit jo në pajtim me Rregulloren e Prokurimit Publik**

Gjetja Rregullorja e prokurimit publik 001/2022, neni 57, paragrafi 1 përcakton se, qëllimi i këtij neni është që në kuadër të kësaj rregullore të definohet hapat të cilët duhet të ndiqen për udhëheqjen e një procedure për sigurim të Konsulentëve / Kontraktoreve Individual për Shërbimeve të veçanta. Më tutje, paragrafi 3, parasheh që, shërbimet e veçanta të cilat nuk mund të sigurohen përmes procedurave të rekrutimit janë shërbime profesionale për të cilat Autoriteti Kontraktues ka nevojë por të cilat shërbime nuk mund t'i plotësojë me stafin që ka.

Gjatë vitit 2024, komuna kishte angazhuar konsulentë për ofrimin e shërbimeve të veçanta, si: Konsulent të Teknologjisë Informatike për Administratën Komunale në vlerë prej 12,480€, Konsulent për Programin i Investimeve Publike në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa në vlerë prej 5,196€, Konsulent për menaxhimin e kontratave dhe përgatitjen e kushteve ndërtimore për lëshimin e lejeve ndërtimore në Drejtorinë e Urbanizmit në vlerë prej 16,440€, si dhe Konsulent për projektim në të njëjtën drejtori në vlerë prej 16,440€. Këto shërbime lidhen me funksione të rregullta të vendeve të punës, të cilat do të duhej të mbuloheshin nga stafi i rregullt, i angazhuar përmes procedurave të rregullta të rekrutimit.

Kjo kishte ndodhur si shkak i mosfunksionimit të duhur të kontrolleve të brendshme të personave përgjegjës për planifikimin dhe rekrutimit e stafit për të plotësuar nevojat e drejtorive përkatëse.

Ndikimi Angazhimi i konsulentëve për shërbimeve të veçanta, shërbime këto që komuna mund ti ofroj me stafin aktual, mund të ndikojnë në transparencën

e procesit dhe po ashtu në cilësinë e punës.

Rekomandimi A10 Kryetari duhet të siguroj që pozitat e rregullta të punës të mbulohen me punonjës të rekrutuar sipas procedurave të rekrutimit të kërkuara me rregullat përkatëse. Derisa, angazhimet për shërbime të veçanta të bëhen vetëm atëherë kur nevojat e drejtorive nuk mund të plotësohen nga stafi aktual i të punësuarve brenda komunës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A11 - Mungesa e komisionit për shqyrtimin e raportit për leje mjedisore komunale

Gjetja Udhëzimi Administrativ Nr.01/2017 për dhënien e lejeve mjedisore komunale, neni 10, përcakton që, për shqyrtimin dhe vlerësimin e raportit për leje mjedisore komunale, Drejtori i Drejtorisë përkatëse komunale, formon komisionin profesional prej tre anëtarëve.

Në pesë (5)¹¹ raste, kemi vërejtur se Drejtoria e Urbanizmit me rastin e dhënies së lejeve mjedisore komunale, nuk kishte formuar komisionin profesional prej tre anëtarëve për shqyrtimin dhe vlerësimin e raportit për leje mjedisore komunale, siç kërkohet me udhëzimin administrativ përkatës. Mirëpo, lejet ishin lëshuar bazuar në raportet e shqyrtuara nga Zyrtari i mjedisit brenda Drejtorisë së Urbanizmit.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mosfunksionimit efektiv të kontrolleve të brendshme dhe mos respektimit të kërkesave të udhëzimit administrativ nga Drejtoria e Urbanizmit.

Ndikimi Mungesa e komisionit profesional prej tre anëtarëve mund të ndikoj në shqyrtimin dhe vlerësimin jo adekuat të raportit për leje mjedisore.

Rekomandimi A11 Kryetari duhet të sigurojë se Drejtoria e Urbanizmit i ka të vendosur të gjithë mekanizmat e nevojshëm për vlerësimin dhe shqyrtimin e lejeve mjedisore në përputhje me rregullat përkatëse.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për Komunën e Malishevës është 11,734,980€. Numri i të punësuarve sipas buxhetit ishte 1,382 ndërsa në fund të vitit numri i tyre ishte 1,433. Gjatë vitit 2024 ishin punësuar 33 të rinj.

Çështja A12 - Zhvillimi i procedurës së rekrutimit bazuar në udhëzimin administrativ të shfuqizuar

Gjetja

Udhëzimi administrativ MFPT-Nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, ka për qëllim përcaktimin e rregullave dhe standardeve minimale të procedurave të konkursit në institucionet e sektorit publik të Republikës së Kosovës.

Në një proces të rekrutimit të zhvilluar nga Drejtoria e Arsimit, bazuar në konkursin e datës 09.07.2024, për angazhimin e 23 personave, procesi ishte zhvilluar në përputhje me metodologjinë dhe kriteret e përcaktuara në Udhëzimin Administrativ nr. 07/2017, i cili ishte shfuqizuar në Mars të vitit 2024, me hyrjen në fuqi të Udhëzimit Administrativ MFPT nr. 01/2024.

Ky udhëzim i ri ka sjellë ndryshime të rëndësishme në procedurat e rekrutimit si në vijim:

- Verifikimi paraprak i aplikacioneve, i cili ishte bërë nga komisioni vlerësues, tashmë është përgjegjësi e njësisë së burimeve njerëzore të institucionit publik. Qëllimi i këtij verifikimi është të vlerësohet nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e konkursit bazuar në aplikacionet e tyre;
- Sa i përket përbërjes së komisionit vlerësues, udhëzimi i ri kërkon që ai të përbëhet nga pesë (5) anëtarë dhe jo nga tre (3), siç ishte praktikuar në këtë rast. Përbërja duhet të përfshijë: eprorin/mbikëqyrësin e pozitës së shpallur në konkurs, dy përfaqësues nga njësia ku është hapur konkursi, një përfaqësues nga njësia e burimeve njerëzore dhe një përfaqësues nga njësitet tjera, sipas vendimit të institucionit. Në këtë proces, komisioni ishte i përbërë vetëm nga anëtarë të Drejtorisë së Arsimit, duke mos respektuar përbërjen e kërkuar;
- Gjithashtu, testi me shkrim, sipas Udhëzimit MFPT 01/2024, duhet të përmbajë së paku tridhjetë (30) pyetje me alternativa të shumëfishta dhe të paktën një (1) ese, me pikë të caktuara për secilën pyetje. Në këtë rast, testi me shkrim kishte vetëm 14 pyetje, gjë që bie ndesh me kërkesat e udhëzimit të ri.

Kjo kishte ndodhur si shkak të mungesës së informimit dhe njohurive nga Drejtoria e Arsimit, lidhur me ndryshimet e fundit të legjislacionit në fuqi.

Ndikimi

Mos informimi dhe mungesa e njohurive të mjaftueshme nga ana e Drejtorisë së Arsimit lidhur me ndryshimet e fundit në legjislacionin në fuqi kanë ndikuar negativisht në mbarëvajtjen e procesit të rekrutimit. Si pasojë, janë aplikuar procedura të vjetra tashmë të shfuqizuara, gjë që ka cenuar ligjshmërinë e procesit dhe krijimit të mundësisë për trajtim jo të barabartë të aplikantëve.

Rekomandimi A12 Kryetari duhet të siguroj që të gjitha procedurat e rekrutimit të zhvillohen në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi në mënyrë që të sigurohet ligjshmëria e procesit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 7,176,785€, prej tyre në 2024 ishin shpenzuar 6,833,083€. Struktura e investimeve kapitale përbëhet nga investimet në infrastrukturën rrugore, rregullimin e lumenjve, mirëmbajtjen investive, ujësjellës, ndërtimin dhe renovimin e objekteve shëndetësore, arsimore dhe kulturore, makineri, furnizime me pajisje mjekësore, pajisje tjera, etj.

Çështja A13 - Vonesa në realizimin e projekteve kapitale

Gjetja

Rregullorja 001-2022 për prokurimin publik, nenit 70.23, "Menaxheri i kontratës do të sigurojë se Operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuara në kontratë. Në kontratat e lidhura ndërmjet komunës dhe operatorëve ekonomik, janë përcaktuar afatet kohore të realizimit të kontratave". Kontrata, kushtet e veqanta, përkatësisht nenit 9 përcakton përfundimin e të gjitha punëve brenda afatit të përcaktuar në kontratë.

Ne kemi vërejtur se në kontratat e përmendura më poshtë, kishte vonesa në realizimin përtej afatit të përcaktuar të përfundimit të punimeve:

- Kontrata "Ndërtimi i rrugëve dhe kanalizimit fekal, atmosferik dhe ndriçimit në qytetin e Malishevës" në vlerë 1,099,942€, e lidhur më 31.07.2023, e cila afatin e realizimit e kishte një vit, do të duhej të përfundonte më 29.07.2024, ndërkohë që deri më 17.12.2024 kontrata ishte realizuar vetëm 38%;
- Kontrata "Realizimi i kontrate Asfaltimi i rrugëve nëpër fshatrat e Komunës së Malishevës Lot 1 dhe Lot 2" në vlerë 580,729€, e lidhur më 29.11.2022, e cila afatin e realizimit e kishte dy vite, do të duhej të përfundonte më 30.09.2024, ndërkohë që deri më 06.11.2024 kontrata ishte realizuar vetëm 43%;
- Kontrata "Ndërtimi i kanalizimit fekal në fshatin Mirushe, Komuna e Malishevës" në vlerë 336,501€, e lidhur më 30.11.2022, e cila afatin e realizimit e kishte një vite, do të duhej të përfundonte më 31.07.2023, ndërkohë që deri në fund të vitit 2024 kontrata ishte realizuar vetëm 79%;
- Kontrata "Ndërtimi e Objektivit të shkollës fillore dhe sallës së edukatës fizike në fshatin Turjak" në vlerë 991,730€, e lidhur më 27.01.2023, e cila do të duhej të përfundonte më 29.08.2024, ndërkohë që deri në fund të 2024 kontrata ishte realizuar vetëm 54%;
- Kontrata "Asfaltimi i rrugëve nëpër fshatrat e Komunës së Malishevës" në vlerë 588,023€, e lidhur më 24.11.2022, e cila do të duhej të përfundonte më 01.07.2024, ndërkohë që deri në fund të 2024 kontrata nuk ishte përfunduar;
- Kontrata "Asfaltimi i rrugëve nëpër fshatrat e Komunës së Malishevës" në vlerë 596,486€, e lidhur më 15.11.2022, e cila do të duhej të përfundonte më 01.07.2024, ndërkohë që deri në fund të 2024, kontrata ishte realizuar vetëm 61%.

Vonesat në realizimin e projekteve kishin ndodhur për shkak të mungesës së mjeteve për pagesën e operatoreve përkatës, si rezultat i hyrjes në obligime pa fonde të mjaftueshme të parapara.

Ndikimi

Vonesat në realizimin e projekteve ndikojnë në mosarritjen e objektivave të komunës, dhe pamundësinë e shfrytëzimit të këtyre projekteve të cilat janë

në shërbim të qytetarëve të komunës.

Rekomandimi A13 Kryetari duhet të sigurohet se janë buxhetuar fonde të mjaftueshme për të gjitha projektet sipas dinamikës së paraparë me kontratë, në mënyrë që të shmangen vonesat në realizim të këtyre projekteve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.3 Çështjet e përbashkëta për kategori të caktuara ekonomike

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me kategori ekonomike si psh: mallrat dhe shërbimet, si dhe investimet kapitale:

Çështja B8 - Mospërdorim i modulit në E-prokurim për menaxhim të kontratave dhe vlerësim të performances së kontraktuesve

Gjetja Rregullorja nr.001/2022 për Prokurimin Publik, neni 70.2 përcakton që: “Vlerësimi i performancës së kontraktuesve do të bëhet: i) në sistem të prokurimit elektronik nëpërmjet modulit për vlerësim të performancës së kontraktuesve; ii) nga menaxherët e kontratës dhe mbikqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, dhe iii) në pajtim me manualin për përdorim të modulit për vlerësim të performancës së kontraktuesve”. Më tutje, sipas nenit 70.24: “Menaxheri i kontratës të sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mbahen dhe arkivohen në modulin për menaxhim të kontratës në sistem të prokurimit elektronik”.

Në 18¹² kontrata, menaxherët e kontratave/projekteve nuk kanë mbajtur dhe arkivuar menaxhimin e kontratave dhe vlerësimin e performancës së kontraktuesve përmes modulit përkatës në sistemin elektronik të prokurimit publik.

Kjo ka ndodhur si rezultat i moskryerjes së punës me përgjegjësi nga ana e menaxherëve të kontratave dhe mbikëqyrësve të drejtpërdrejtë të tyre.

Ndikimi Mos mbajtja dhe arkivimi i kontratave përmes sistemit të prokurimit publik mund të ndikoj në një menaxhim jo të mirëfilltë dhe transparent të kontratave, si dhe nuk ofron mundësi të mjaftueshme që menaxhmenti të merr informata me kohë në lidhje me progresin dhe performancën e kontratave.

Rekomandimi B8 Kryetari duhet të sigurojë se menaxherët e kontratave përdorin modulin përkatës në sistemin e prokurimit publik për menaxhimin e kontratave dhe vlerësimin e performancës sipas rregullave përkatëse.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.4 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 122,794,739€, pasurive jokapitale është 322,620€, si dhe e stoqeve 61,584.

Çështja B9 - Mos mbyllja e investimeve në vijim dhe regjistrimi i tyre si pasuri në përdorim dhe mos-funksionalizimi i sistemit e-pasuria

Gjetja Rregullorja nr.02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare, neni 11 përcakton që: “Pas përfundimit të procesit të investimit pasuria jo financiare kapitale do të klasifikohet si pasuri jo financiare në përdorim. Nga momenti i aftësimit të pasurisë për përdorim do të zbatohet edhe vlerësimi”. Gjithashtu, neni 6 i rregullores së njëjtë thekson se, pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin e-pasuria.

Në 16 mostra në vlerë 938,949€, pasuritë të blera (ndërtuara) gjatë viteve 2015-2021 për të cilat nuk është bërë ende pranimi teknik, figurojnë në regjistra si investime në vijim, edhe pse të njëjtat shfrytëzohen nga komuna dhe do të duhej të regjistroheshin si pasuri në përdorim dhe për to të kalkulohej amortizimi. Në pamundësi të sigurimit të informatave të sakta për kohën e funksionalizimit të këtyre pasurive, ne nuk kemi mundur të kalkulojmë vlerën e gabimit të zhvlerësimit, përkatësisht vlerën e mbivlerësimit të pasurive në PFV.

Gjithashtu, komuna nuk kishte përdorur softuerin sistemin e-pasuria për regjistrimin dhe mirëmbajtjen e pasurive nën 1,000€. Në mungesë të përdorimit të sistemit e-pasuria, komuna kishte evidentuar këto pasuri në një bazë të dhënave në formatin Excel për të cilat nuk aplikohet zhvlerësimi.

Kjo kishte ndodhur për shkak të funksionimit jo të mirë të kontrolleve të brendshme në menaxhimin e pasurive jo financiare ndër vite. Ndërsa mos funksionalizimi i e-pasurisë ishte shkaktuar si rezultat i mungesës së veprimeve të nevojshme për ta funksionalizuar sistemin e-pasuria.

Ndikimi Mungesa e pranimit teknik për pasuritë e përfunduara që janë në përdorim nga komuna ndikon në paqartësinë e statusit të tyre duke shkaktuar vlerësim jo të drejtë dhe raportim të pa saktë të tyre. Ndërsa mirëmbajtja manuale e të regjistrit të pasurive nën 1,000€ rrit mundësinë e gabimeve në mirëmbajtjen e regjistrave, shlyerjeve potenciale, keqpërdorimit, humbjes apo të tjetërsimit të tyre.

Rekomandimi B9 Kryetari duhet të forcojë kontrollet e brendshme në menaxhimin e pasurive jo financiare, duke siguruar pranimin teknik të projekteve të përfunduara dhe regjistrimin e tyre si pasuri në përdorim në mënyrë që të njëjtat të raportohen drejtë dhe saktë. Po ashtu, Kryetari duhet të sigurohet që të funksionalizoj sistemin e-pasuria me qëllim të përmbushjes së kërkesave që dalin nga ligjet në fuqi dhe sigurisë së informatave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.5 Të arkëtueshmet

Në raportin vjetor financiar për vitin 2024, Komuna e Malishevës ka paraqitur llogari të arkëtueshme në shumën prej 4,849,891€. Kjo shumë përbëhet nga: tatimi në pronë në vlerë prej 3,390,288€, taksa komunale për ushtrimin e veprimtarisë në vlerë prej 1,269,255€, si dhe qiratë për shfrytëzimin e pronës komunale në vlerë prej 190,348€.

Çështja B10 - Menaxhim jo efikas i llogarive të arkëtueshme

Gjetja

Ligji nr. 06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme, neni 27 përcakton që “Nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjobën nëse ka të këtillë, ose detyrimet tatimore të papaguara, në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditëve pune pas ditës së fundit për pagesë, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo më vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori”.

Pika 3 e Aktvendimit për taksën në ushtrimin e veprimtarisë afariste përcakton që: shumën e caktuar në pikën 1 obliguesi mund t'a paguaj në dy këste gjatë vitit fiskal, dhe atë kësti i parë deri me 30 Qershor, dhe kësti i dytë deri më 31 Dhjetor duke filluar në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të këtij aktvendimi.

Llogaritë e arkëtueshme për vitin 2024 ishin j 4,849,891€, prej të cilave 3,390,288€ apo 70% ishin për tatimin në pronë. Komuna kishte dërguar letër rikujtim për detyrimet e papaguara ndaj disa debitorëve për përmbushjen e detyrimeve të papaguara të tatimit në pronë, megjithatë nuk kishte pasur asnjë rezultat në arkëtimin e këtyre borxheve, marrë parasysh rritjen e borxheve të tatimit në pronë krahasuar me vitin paraprak. Në 37 raste të identifikuar komuna nuk kishte marrë masa shtesë, si ajo e veprimeve ligjore përmes përmbaruesit lidhur me mbledhjen e këtyre borxheve.

Gjithashtu, në 21 raste të llogarive të arkëtueshme nga taksa në ushtrimin e veprimtarisë afariste në vlerë 116,222€, komuna nuk kishte ndërmarrë veprime ligjore për mbledhjen e këtyre borxheve, edhe pse ishte tejkaluar afati i përcaktuar në Aktvendimin për pagesë.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mungesës së veprimeve të vazhdueshme, përfshirë ato ligjore dhe hartimit të politikave nga ana e komunës për mbledhjen e të arkëtueshmeve.

Ndikimi

Mos arkëtimi me kohë i të arkëtueshmeve rezulton me të hyra buxhetore më të ulëta nga fondi i të hyrave vetanake. Rrjedhimisht, kjo mund të ndikojë edhe në arritjen e objektivave të Komunës, duke pamundësuar investime në projekte që financohen nga këto fonde.

Rekomandimi B10

Kryetari duhet të sigurojë forcimin e mekanizmave të kontrollit në mbledhjen e borxheve nga debitorët, duke i shfrytëzuar të gjitha mjetet në dispozicion, pa përjashtuar edhe veprimet ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.6 Funksioni i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) funksionon me një staf prej tre anëtarësh: drejtori i NjAB-së dhe dy auditorë. Për vitin 2024, NjAB kishte planifikuar realizimin e shtatë (7) auditimeve, të cilat janë përmbyllur gjatë vitit në fushat si: menaxhimi i pasurisë, shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e veturave zyrtare, vlerësimi i ligjshmërisë dhe menaxhimit në Drejtorinë e Urbanizmit, shërbimet publike, subvencionet në bujqësi, financat dhe prokurimi. Si rezultat i këtyre auditimeve, janë dhënë gjithsej 18 rekomandime. Deri në fund të vitit, 8 prej tyre janë zbatuar, 6 janë në proces të zbatimit, ndërsa 4 mbeten të pazbatuara. Komuna ka themeluar Komitetin e Auditimit, mirëpo gjatë vitit 2024 ky komitet nuk ka mbajtur asnjë takim.

Çështja A14 - Mos funksionimi i Komitetit të Auditimit

Gjetja

Udhëzuesi Administrativ për themelimin dhe funksionimin e komitetit të auditimit në subjektin e sektorit publik nr. MF-Nr. 01/2019, neni 8 parasheh që takimet e komitetit të auditimit mbahen së paku katër (4) herë në vit dhe ftohen nga kryesuesi i komitetit të auditimit.

Për vitin 2024, Komiteti i Auditimit nuk kishte mbajtur asnjë takim/mbledhje duke pamundësuar ndihmën për ZKA në përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, shqyrtimin e raporteve dhe dhënien e mbështetjes së NjAB-së.

Kjo kishte ndodhur për shkak se komuna nuk kishte zbatuar një skemë të qartë të kompensimit të tyre.

Ndikimi

Mos funksionimi i komitetit të auditimit, ndikon negativisht në efektivitetin e kontrolleve të brendshme të komunës dhe funksionimin e auditimit të brendshëm.

Rekomandimi A14

Kryetari duhet të sigurojë funksionimin e komitetit të auditimit që të rishikojë në mënyrë kritike planet e auditimit të brendshëm për të konfirmuar se ato bazohen në rrezik dhe t'i ofrojë sigurinë e kërkuar menaxhmentit. Gjithashtu, Komiteti duhet të monitoroj veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me rekomandimet e auditimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ¹³	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Burimet e fondeve	19,740,806	22,029,503	21,618,284	20,008,369	16,705,105
Grante Qeveritare - Buxheti	18,823,957	19,451,799	19,399,450	17,967,299	14,942,625
Financimi përmes huamarrjes	0	0	0	0	92,883
Të bartura nga viti i kaluar	0	191,423	188,564	285,526	640,071
Të hyrat vetanake	916,849	2,058,709	2,030,271	1,755,544	1,029,526
Donacionet vendore	0	508	0	0	0
Donacionet e jashtme	0	327,064	0	0	0

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 2,288,697€. Kjo rritje është rezultat i mjeteve shtesë nga granti qeveritar prej 627,842€, të hyrave vetanake si rezultat i tejkalimi të planit të hyrave 1,141,860€, të hyrave të bartura nga viti paraprak 191,423€ dhe donacioneve 327,572€.

Në vitin 2024 Komuna e Malishevës ka shpenzuar 98% të buxhetit përfundimtar, me një rënie në realizim të buxhetit prej 1% krahasuar me vitin 2023, ku realizimi ishte 99%. Shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.


Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	19,740,806	22,029,503	21,618,284	20,008,369	16,705,105
Pagat dhe mëditjet	11,111,696	11,739,555	11,734,980	10,610,631	9,033,233
Mallrat dhe shërbimet	1,742,707	1,957,307	1,924,973	2,045,641	1,820,119
Komunalitë	655,000	655,000	645,999	514,406	452,575
Subvencionet dhe transferet	400,000	500,856	479,249	699,266	496,864
Investimet Kapitale	5,831,403	7,176,785	6,833,084	6,138,425	4,902,314

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 627,859€. Kjo rritje vjen kryesisht për mbulimin e obligimeve që kanë rrjedh nga kontrata kolektive. Realizimi i kësaj kategorie ishte 100%.
- Buxheti final për mallra dhe shërbime gjithashtu ishte rritur për 214,600€, në krahasim me buxhetin fillestar, kjo rritje vjen si rezultat bartjes së të hyrave vetanake dhe donacioneve për mbulimin e nevojave të komunës për shpenzime në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve. Ndërsa, ekzekutimi i buxhetit në këtë kategori ishte 98%.
- Buxheti i komunalive nuk kishte ndryshime, derisa realizimi në fund të vitit ishte 99%.
- Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte rritur për 100,856€, në krahasim me buxhetin fillestar. Kjo rritje vjen për subvencionimi e fermerëve, subvencionimin e kulturës, arsimit dhe sportit nga të hyrat e bartura nga viti paraprak dhe donacioneve. Realizimi në këtë kategori ishte rreth 96% e buxhetit final.
- Buxheti final në krahasim me buxhetin fillestar për investime kapitale ishte rritur për 1,345,382€. Kjo rritje ishte për financimin e projekteve kapitale që do përmirësojnë infrastrukturën e komunës. Buxheti në këtë kategori është shpenzuar rreth 95%.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2024



Të hyrat e realizuara nga komuna për vitin 2024 ishin në vlerë prej 1,893,024€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, taksat për leje të ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga nga licencat, të hyrat nga participimet, të hyrat nga qiraja dhe shfrytëzimi i hapësirës publike. Për vitin 2024, Komuna kishte planifikuar të hyra në vlerë prej 916,849€, duke tejkaluar planin e të hyrave të planifikuara je në realizim për 976,175€. Në krahasim me vitin e kaluar niveli i inkasimit të të hyrave, ka rritje prej 303,055€, që kryesisht i përket të hyrave të tatimit në prone taksa për leje të ndërtimit dhe leje mjedisore.

Në shumën totale të pranimeve për vitin 2024, nuk janë të përfshira edhe të hyrat nga gjobat në trafik, gjobat nga Gjykatat dhe Agjencioni i Pyjeve në vlerë prej 474,544€, të cilat grumbullohen nga Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), e të cilat i alokohen Komunës për shpenzim. Këto të hyra nuk janë të përfshira në tabelën e më poshtme, për arsye se këto i planifikojnë dhe realizojnë ministritë e linjës.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Pranimet	2023 Pranimet	2022 Pranimet
Totali i të hyrave	916,849	916,849	1,893,024	1,589,969	916,122
Të hyrat tatimore	449,583	449,583	748,261	638,815	370,414
Të hyrat jo tatimore	467,266	467,266	1,143,350	949,377	540,917
Të hyrat tjera	0	0	1,412	1,777	4,791

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PVF-të të vitit 2023 të Komunës së Malishevës ka rezultuar me 13 rekomandime kryesore. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2024, tre (3) rekomandime janë zbatuar dhe 10 rekomandime nuk janë zbatuar siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2023	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Kryetari duhet të forcojë kontrollet dhe të përmirësojë proceset e regjistrimit dhe raportimit financiar për të siguruar që LI/A në PVF të jenë plotë dhe të sakta.	Nuk janë ndërmarrë veprime për t'a zbatuar këtë rekomandim, komuna nuk ka siguruar dokumentacionin e disa mostrave nga LL.A, me ç'rast edhe këtë vit shpalosja e LL.A në PVF nuk ishte e saktë.	Nuk ka filluar zbatimin

2.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të forcojë kontrollet gjatë vlerësimit të projekteve, duke siguruar që para inicimit të procedurave të prokurimit për çdo projekt kapital të ketë fonde të mjaftueshme për realizimin e projekteve.	Nuk janë ndërmarrë veprime për këtë rekomandim, edhe këtë vit komuna kishte hyrë në obligime kontraktuale pa fonde të mjaftueshme.	Nuk ka filluar zbatimin
3.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë që të gjitha avancet për udhëtime zyrtare duhet të arsyetohen dhe shumat e pashpenzuara të kthehen në afat prej 15 ditësh pas kthimit nga udhëtimi. Në të kundërtën, duhet të sigurojë marrjen e veprimeve ligjore ndaj personave përgjegjës të cilët nuk i kanë arsyetuar ose kthyer mjetet e pranuar-avancet.	Nuk janë ndërmarrë veprime për këtë rekomandim, edhe këtë vit komuna kishte vonesa në mbylljen e avanseve për udhëtime zyrtare.	Nuk ka filluar zbatimin
4.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se respektohen hapat e përcaktuar me rregullat në fuqi sa i përket realizimit të pagesave në mënyrë që gjatë procedimit të pagesave, të bëhet fillimisht zotimi i mjeteve, pastaj të nxirret urdhër blerja dhe në fund të pranohet puna/shërbimi dhe të kryhet pagesa.	Rekomandimi është zbatuar.	I zbatuar
5.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të rishikoj shkaqet e mos përdorimit të sistemit e-prokurimi dhe të ndërmarrë masa shtesë të kontrollit për të siguruar që menaxhimi i kontratave do të mbahet dhe arkivohet në sistemin elektronik të prokurimit publik.	Nuk janë ndërmarrë veprime për këtë rekomandim, edhe këtë vit komuna nuk kishte realizuar menaxhimin e kontratave përmes platformes e-procurimi.	Nuk ka filluar zbatimin
6.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të sigurojë që planifikimi buxhetor i shpenzimeve të bëhet sipas kategorive adekuate si dhe pagesat të regjistrohen në kode përkatëse ekonomike në përputhje me planin kontabël të aprovuar nga Thesari.	Nuk janë ndërmarrë veprime për t'a zbatuar këtë rekomandim, edhe këtë vit komuna ka regjistruar shpenzime në kategori ekonomike joadekuate dhe si rezultat i kësaj kemi pasur keqklasifikim të shpenzimeve.	Nuk ka filluar zbatimin

7.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se janë marrë veprimet e nevojshme që projektet e aprovuara të realizohen sipas planifikimit. Nëse paraqitet nevoja për ridestinim të fondeve të projekteve, kjo të realizohet përmes procedurave të përcaktuar me rialokim në pajtim me Ligjin mbi ndarjet buxhetore.	Nuk janë ndërmarrë veprime për këtë rekomandim, edhe këtë vit komuna kishte ndryshime në shumat e ndara buxhetore për projekte kapitale pa aprovim të kuvendit komunal.	Nuk ka filluar zbatimin
8.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të rishikoj kontrollet e vendosura në procesin e planifikimit dhe inicimit të projekteve investuese dhe të siguroj se gjatë përgatitjes së specifikave teknike për projekte investuese të kenë të përgatitur edhe projektin ekzekutiv, dhe të njëjtin t'ia bashkëngjis dosjes së tenderit me rastin e publikimit të saj.	Nuk janë ndërmarrë veprime për këtë rekomandim, edhe këtë vit komuna kishte lidhur kontrata për projekte pa u hartuar paraprakisht projektet ekzekutuese.	Nuk ka filluar zbatimin
9.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë se të gjitha pasuritë jo financiare të komunës, janë të plota dhe të saktë në regjistrat përkatës të pasurive jo financiare dhe PVF.	Rekomandimi është zbatuar, pasi këtë vit nuk ka rezultuar çështja e njëjtë.	I zbatuar
10.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë ndërmarrjen e hapave konkrete për gjetjen në një zgjidhje për caktimin e një depo ku furnizimet me material zyre pranohen dhe vendosen në depo duke regjistruar hyrjen dhe daljen e tij. Kjo do të ndihmojë që zyrtari përgjegjës i logjistikës do t'i regjistrojë hyrjet dhe daljet e pasurive jo financiare duke mbajtur shënime të sakta mbi rezervat e pasurive jo financiare të komunës.	Rekomandimi është i zbatuar, pasi këtë vit nuk ka rezultuar çështja e njëjtë.	I zbatuar
11.	Pasuritë	Kryetari duhet të ndërmarr veprimet e nevojshme në forcimin e kontrolleve të brendshme për korrigjimin e regjistrat të pasurive, dhe në veçanti duke i verifikuar dhe korrigjuar vlerat e pasurive me statutin "Investime në vijim" dhe nëse jetëgjatësia e përdorimit të pasurive është ajo e përcaktuar me rregullore dhe që vlera e pasurive të prezantohet e saktë. Po ashtu, duhet të sigurojë formimin e komisionit që procesi i inventarizimit kryhet me kohë para hartimit të PVF-ve.	Nuk janë ndërmarrë veprime për këtë rekomandim, edhe këtë vit komuna nuk kishte bërë mbylljen e investimeve në vijim dhe regjistrimin e tyre si pasuri në përdorim..	Nuk ka filluar zbatimin

12.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të sigurojë se mbledhja e LI.A nga tatimi në pronë bëhet sipas kërkesave dhe mënyrave të përcaktuara ligjore. Ndërsa për LI.A nga taksa në biznes dhe të qirave, të shqyrtohen të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur politika dhe rregullore dhe deri përmes mjeteve juridike me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e borxheve.	Nuk janë ndërmarrë veprime për këtë rekomandim, edhe këtë vit komuna nuk ka ndërmarrë veprime për mbledhjen e llogarive të arkëtueshme.	Nuk ka filluar zbatimi
13.	Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të përmirësojë menaxhimin e fondeve për të siguruar që obligimet financiare të kryhen në kohë dhe brenda afatit prej 30 ditëve, duke përfshirë hartimin e një analize të hollësishme buxhetore për të shmangur vonesat në pagesat e faturave.	Nuk janë ndërmarrë veprime për këtë rekomandim, edhe këtë vit kishte vonesa në pagesën e obligimeve ndaj furnitorëve.	Nuk ka filluar zbatimi

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Blerina Krasniqi, Drejtore e Auditimit



Elvir Krasniqi, Udhëheqës i ekipit



Albana Sahiti, Anëtare e ekipit



Donjeta Rama, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi



PRANUAR MË:
ACCEPTED ON: 24/06/2025
PRIMLJENË:
01/725
Mr.No.Br.

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2024 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Malishevës, për vitin 2024 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- **pajtohem**/ me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe zotohem për përmbushjen e rekomandimeve të dalura nga auditimi në fjalë.
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Ekrem Kastrati

Kryetar i Komunës së Malishevës

Data: 23.06.2025, Malishevë

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare¹⁴ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet¹⁵, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinion i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ 62593360 PREMIUM BAKERY SHPK, 11 548,01 €, 62524139 RRUGE LOKALE, 30 000,00 €, 62518013 SPECIFIKACION 30.000,00€, 62518013 SPECIFIKACION 7.651,59€, VENDIM GJYQI P nr1527/22, 32 000,00 €, 62573800 INVESTO PRO SHPK, 20 000,00 €, 62593360 ERST BAU SHPK, 24 877,73 €, 62592450 SPECIFIKACION, 3 814,70 €, 62573800 INVESTO PRO SHPK, 31 436,60 €,
- ⁶ 1. Taksa për ushtrimin e veprimtarisë, mungesa e dokumentacionit: Bag Sh.p.k., Sabit Shala B.I, Hotel-Berisha, Krenar I. Kryeziu BI, „Burimi“, „Shpresimi“, Lorik-Com shpk, Pajtimi Mall Sh.p.k., 2. Qiratë nga shfrytëzimi i pronës komunale: Ipko Telecommunication L.L.C., Nënvlërësimi i llogarive të arkëtueshme nga taksa për ushtrimin e veprimtarisë- Telekomit i kosovës.
- ⁷ 62524153 SHERBIME TIERA KONTRAKTUSE, 18 000,00 €, Vonesë në pagesë 173 ditë. 62524447 KOMPENSIMI I PËRFAQËSIMIT BRENDA VENDIT, 1 180,00 €, Vonesë në pagesë 46 ditë 62524052 SHERBIME TEKNIKW, 6 000,00 €, Vonsa në pagesë deri në 140 ditë 62524751 SHERBIME TEKNIKE, 4 000,00 €, Vonesë në pagesë 108 ditë. 62524014 FURNIZIM ME DOK BLLANKO, 3 583,00 €, Fatura është paguar në vonesë prej 48 ditëve. 62524100 MOBILJE, 20 043,00 €, Vonesa në pagesë deri në 88 ditë. 62524693 DRUTË DHE PRODHIMET E DURTIT PËR NGROHJE, 30 037,10 €, Vonesë në pagesë 96 ditë. 62524398 DERIVAT PËR VETURA, 3 731,10 €, Vonesë në pagesë 68 ditë. 62524637 DRUTË DHE PRODHIMET E DRURIT PËR NGROHJE, 50 000,00 €, Vonesë në pagesë 65 ditë, 62524780 RRUGËT LOKALE 80,000€, Fatura prej 387,360€ ishte vonuar për pagesë prej 45 ditë 62524816 RRUGËT LOKALE 33,249€, Vonesë në pagesën e faturës prej 33249€ ishte vonuar për pagesë prej 4 muaj #62524517 RRUGËT LOKALE 20,000€, Fatura prej 20000€ ishte vonuar për pagesë 5 ditë 62524002 RRUGE LOKALE 349,994€, Fatura prej 349994€ ishte vonuar për pagesë 120 ditë 62524466 RRUGËT LOKALE 41,401€, Fatura prej 111,960€ është paguar me vonës prej 28 ditë 62524472 RRUGËT LOKALE 50,000€, fatura prej 70559€ ishte vonuar për pagesë për 20 ditë 62524007 RRUG LOKALE 36,919€, Pagesa prej 36919€ për pagesën e pjesërishtme të faturës 02/2023 ne vlere 103,000eur ishte bërë me vonesë prej 7 muajsh 62524587 RRUGET LOKALE, 100 000,00 €, Pagesa e fatures prej 133249€ ishte vonuar per pagesë 18 ditë 62524418 RRUGË LOKALE, 52 315,12 €, Fatura prej 52,315€ ishte vonuar për pagesë 60 ditë 62524001-RRUGE LOKALE KONTR NR 03/01, 55,728€, Pjesa e mbetur pa paguar e faturës prej 55,728€ ishte vonuar për pagesë për 120 dite
- ⁸ 62524520 NDËRTESAT ARSIMORE 49,999€, 62524322 RRUGE LOKALE 29,051€, #62524517 RRUGËT LOKALE 20,000€, 62524209 RRUGE LOKALE 59,482€ 62524433 RRUGË LOKALE 20,000€, 62524774 RRUGËT LOKALE 80,732€, 62524225 RRJETET E KANALIZIME 25,500€, 62524321 RRUGE LOKALE 73,000€, 62524817 RRJET KANALIZIMI 39,000€, 62524211 RRUGET LOKALE 50,002€, 62524516 NDËRTESART ARSIMORE 20,000€.
- ⁹ Këtë çështje e rregullonte edhe Rregulla dhe udhëzuesi operativ për prokurim publik të datës 01/02/2021, neni 56.15
- ¹⁰ Rregullimi dhe ndërtimi i kanalizimeve të ujërave të zeza në fshatrat Banjë, Mirushë, Kërvasari, Temeqinë, Ngucat, Senik, Pagarushë, Kijevë, Gurbardhë, Shkarashnik, Drenoc, Vermicë, Bellanicë, Gurishtë, Burim, Malishevë, Bubavecë, Panorc, Astrazup, Dragobil, Pllqoc, Balincë, Berishë, Jançishtë, Carrallukë dhe Lladroc, për të cilën ka lidhur kontratë me vlerë 408,920€; Punimi i lapidarit të dëshmorit Ilaz Javori në fshatin Llazicë, Komuna Malishevë, për të cilën ka lidhur kontratë me vlerë 10,710€
- ¹¹ 1. Diti Group Sh.p.k., NNT Vëllezërit Sopi, Hysenaj Construction Sh.p.k., Kajtaz Gashi B.I, ASN Invest Sh.p.k.

- ¹² Rregullimi dhe ndërtimi i kanalizimeve të ujërave të zeza në fshatrat Banjë, Mirushë, Kërvasari, Temeqinë, Ngucat, Senik, Pagarushë, Kijevë, Gurbardhë, Shkarashnik, Drenoc, Vermicë, Bellanicë, Gurishtë, Burim, Malishevë, Bubavecë, Panorc, Astrazup, Dragobil, Plloqic, Balincë, Berishë, Jançishtë, Carrallukë dhe Lladroc, me vlerë të kontratës 408,920€; Punimi i lapidarit të Dëshmorit Ilaz Javori në fshatin Llazicë Komuna Malishevë me vlerë të kontratës 10,710€; Punimi i murit mbrojtës dhe rregullimi i rreth rrotullimit në fshatin Pagarushë Komuna Malishevë, me vlerë të kontratës 74,106€; Ndërtimi, trajtimi dhe pastrimi i shtratit të lumit me strukturën përcjellëse nga ura në qendër deri tek tranziti në Malishevë, me vlerë të kontratës 1,487,454€; Renovimi i objekteve të institucioneve arsimore në Komunën E Malishevës, me vlerë të kontratës 299,452€; Ndërtimi i objektit të shkollës fillore dhe sallës së edukatës fizike në fshatin Turjakë (aneks), me vlerë të kontratës 51,009€; Rregullimi i parkut në fshatin mirushë Komuna Malishevë - faza e parë (aneks), me vlerë të kontratës 29,742€; Renovimi i hapësirës në objektin afarist Dardania në pjesën e Komunës së Malishevë, me vlerë të kontratës 10,920€; Shërbime me binë, ndriçim profesional dhe mjete zërimi për organizimin e festivaleve në komunën e Malishevës, me vlerë të kontratës 52,400€; Servisimi dhe mirëmbajtja e paisjeve të radiologjisë në kuadër të QKMF-së Dr. Shpetim Robaj Malishevë, me vlerë të kontratës 71,973€; Shërbime Konsulente-Konsulent i IT-së për administratën e Komunës Malishevë, me vlerë të kontratës 12,480€; Ofrimi i shërbimeve shëndetësore, me vlerë të kontratës 1,288,406€; Larja e veturave zyrtare, me vlerë të kontratës 13,700€; Furnizimi, montimi i perdeve në objektin e ri të qendrës për punë sociale, me vlerë të kontratës 4,140€; Furnizimi me klima për nevojat e zyrave në drejtorinë për shëndetësi, me vlerë të kontratës 6,443€; Furnizim me lektyra shkollore për bibliotekat e institucioneve edukative arsimore Komuna Malishevë, me vlerë të kontratës 158,554€; Spërkatja nga toka e zona endemike nga ethet homorrogjike, me vlerë të kontratës 59,975€; Shërbime konsulente profesionale në drejtorinë e financave dhe buxhet, me vlerë të kontratës 5,196€.
- ¹³ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ¹⁴ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ¹⁵ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.